

VENDIM
Nr. 856, datë 10.12.2014

**PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM, PA SHPËRBLIM, NGA
DREJTORIA E SHËRBIMIT TË TRUPIT DIPLOMATIK PËR MINISTRINË E
PUNËVE TË JASHTME, TË PASURISË NR. 1/586/5, ZONA KADASTRALE NR. 8380,
TIRANË, PËR T'U PËRDORUR SI SELI E SEKRETARIATIT TË FONDIT TË
BALLKANIT PERËNDIMOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 12, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, për një periudhë pesëvjeçare, dhjetor 2014 - dhjetor 2019, nga Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik për Ministrinë e Punëve të Jashtme, të pasurisë nr. 1/586/5, zona kadastrale nr. 8380, Tiranë, për t'u përdorur si seli e Sekretariatit të Fondit të Ballkanit Perëndimor.
 2. Ministrisë së Punëve të Jashtme i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pasurisë së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t'ua japë në përdorim të tretëve.
 3. Me përfundimin e afatit pesëvjeçar, prona t'i kthehet Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomatik.
 4. Shpenzimet për mobilimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e zyrave të selisë së Sekretariatit të Fondit të Ballkanit Perëndimor i ngarkohen Ministrisë së Punëve të Jashtme.
 5. Ngarkohen Ministria e Punëve të Jashtme dhe Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama